


eService (portal për studentët)

eService është aplikacion portal i UEJL-së i bazuar në ueb, që siguron qasje on-line të përbashkët në shërbimet e UEJL-së. Portali ofron 24 orë qasje në një mori shërbimesh që janë në dispozicion për studentët, stafin akademik dhe administrativ, si për shembull informatë për financat, notat, orarin, regjistrimin dhe afatet e provimeve. Qëllimi i eService është që të krijojë një qytezë virtuale - një vend për të studiuar, punuar, bashkëpunuar dhe për t'u argëtuar!



Shërbimi i notimit elektronik (eGrading)

Notimi elektronik është një aplikacion i bazuar në ueb, i adoptuar për regjistrimin elektronik të notave. Dorëzimi elektronik i notave e minimizon vonesën e dorëzimit të tyre dhe mundëson një transparencë optimale në notim. Ky softuer është zhvilluar nga ekipi për zhvillimin e softuerit të Universitetit, në përputhje me kërkesat e menaxhmentit të Universitetit për notimin transparent.

Apply.seeu.edu.mk

Apply është një softuer i bazuar në ueb, i adaptuar për aplikim on-line të studentëve të ri. Ky softuer e shpejton procedimin e të dhënave. Kjo, do t'i ndihmojë studentët që të shmangin pritjen në radhë gjatë aplikimit dhe regjistrimit dhe do të ndihmojë administratën në procedimin e aplikacioneve me lehtësi dhe saktësi.


Career Service Manager (CSM)

CSM është vegël menaxheriale e bazuar në ueb, e mundësuar nga Qendra e Karrierës. Është një softuer i sofistikuar që lejon studentët dhe punëdhënësit të komunikojnë në mënyrë efektive on-line. Studentët kanë mundësi të ngarkojnë biografite (CV) e tyre në këtë softuer në një format me një qasje shumë të lehtë nga punëdhënësit. Studentët mund t'i shohin shpalljet për punë dhe në mënyrë automatike nga e-maili i tyre mund t'i marrin të dhënat për punëdhënësin. Punëdhënësve u është dhënë mundësia e qasjes në këtë softuer, ku edhe mund të krijojnë profilin e tyre dhe të përzgjedhin biografite (CV) e ngarkuara të studentëve.



Burimet elektronike (E-Resources)

Përmes bazës së të dhënave on-line për hulumtime EBSCO, për studentët dhe stafin e UEJL-së është siguruar një qasje të drejtpërdrejtë në një mori burimesh elektronike, si për shembull revistat on-line, botimet periodike, gazetat dhe burimet tjera, për të plotësuar njohuritë e tyre në klasë ose për t'ju ndihmuar atyre në hulumtime.



UEJL – Promotor i teknologjive bashkëkohore (TI) në arsim

→ Aplikoi

Lidhje interneti me shpejtësi të lartë

Në bashkëpunim me Telekomunikacionin e Maqedonisë, UEJL ka siguruar lidhje të shpejtë interneti (më shumë se 20Mb/s), duke përdorur teknologjinë e fibrave optik, e cila ofron një lidhje të qëndrueshme dhe të sigurt. Me më shumë se 450 kompjuterë, Qendrat Kompjuterike (ndërtesat 700, 701) dhe Biblioteka e Universitetit (ndërtesa 702), janë vende të dedikuara, ku studentët kanë qasje në internet dhe në burimet elektronike të Universitetit, gjatë ditëve të punës nga ora 08:00 deri në orën 22:00 dhe gjatë të shtunave nga ora 08:00 deri në orën 17:00.

Dërrasat e bardha interaktive SMART Board

UEJL është pioniere në artin e arsimit të lartë në rajon, në përdorimin e dërrasave të bardha interaktive SMART Board, të vlerësuara nga administratorët e shkollave dhe specialistët e teknologjisë si veglat më të mira teknologjike dhe më efektive për arsimin e lartë.

UEJL ka krijuar një mjedis arsimor për studentët dhe mësimdhënësit, që të dëshmojnë përmes teknologjisë, duke zbatuar mësimdhënien përmes dërrasave të bardha interaktive SMART Board. Teknologjia interaktive e dërrasës së bardhë ofron fleksibilitet në klasë dhe në përgatitje. Mësimdhënësit janë në



gjendje të kenë qasje në burimet më të mira arsimore dhe materialet interaktive nga mbarë bota për disa çaste. Kjo teknologji nxit mësimdhënësit në mësimdhënie dhe studentët në mësinxënie.



Qyteza e UEJL-së bëhet Wireless

Universiteti i Evropës Juglindore është zotuar se studentëve, së shpejti do t'u ofrojë një komoditet të lartë në qasjen e burimeve në rrjetë, kështu duke u bërë qyteza e parë universitare wireless në rajon. Kjo gjë do t'u sigurojë studentëve lirinë e qasjes në internet kur dhe nga ku të duan.

Shërbime elektronike të mundësuar nga Google

Shërbimet elektronike në qytetë të UEJL-së të mundësuar nga Google ju ofrojnë studentëve qasje në teknologjinë dhe shërbimet e fundit të uebit. Studentët, stafi akademik dhe administrativ këmbëjnë informata dhe ide më lehtë, duke përdorur veglat e gjeneratës së ardhshme të komunikimit dhe bashkëpunimit. Studentët me ndihmën e Google kanë qasje në e-mailin e tyre, në realizimin e kontakteve on-line, në kalendarin akademik dhe mundësi të tjera,



duke filluar nga klasat, laboratorët, bufetë, biblioteka dhe nga shtëpia.



Aleanca Akademike MSDN

Microsoft dhe UEJL prezantojnë Programin Aleanca Akademike MSDN (MSDN AA). MSDN AA është mënyra më e lehtë dhe më e lirë për studentët dhe stafin për të marrë softuerin e fundit të Microsoft pa pagesë, duke filluar nga sistemet operative (Windows Server), Desktop Operating Systems (Windows XP, Windows Vista), Microsoft Developer Tools (Visual Studio 2003, 2005, 2008), SQL Server 2000, 2005, 2008 dhe shumë të tjera.



Angel (e-learning)

E-learning është një pjesë e rëndësishme e përvojës akademike në UEJL dhe jemi zotuar për inkurajimin e zhvillimit të të njëjtit. Thuajse të gjitha lëndët janë në një përkrahje të vazhdueshme nga pajisjet on-line, Angel, që i lejon studentët të kenë qasje në materialet e lëndës, të dorëzojnë projektet dhe detyrat e shtëpisë dhe të komunikojë on-line me mësimdhënësin, në çdo kohë, në njërin nga 450 kompjuterët në qytetë, të dedikuar për studentët ose përmes internetit nga shtëpia.